



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT  
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT**

Nr. 17 Prot.,

Tiranë, më 03.02.2025

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar, me Urdhërin nr. 234, datë 25.10.2024 “Për një ndryshim në Urdhërin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 4, datë 03.02.2025 si më poshtë:

**I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Veçantë. Dosje personale nr. 2670 dhe dosje pune nr. 42 në ngarkim të E. H., me 2 volume në total me 559 (pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1972-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

**1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:**

- Mbështetur në nenin 44, pika 4 të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e

klasifikuar”, si dhe në Vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.01.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH, të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.
3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar, t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.
4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I KDZH**

**Dr. Gentiana Sula**

